



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit  
Municipality of Hani i Elezit

02. Nr. 334 2011  
Dt: 19.07.2011

Duke u bazuar në Ligjin e shërbyesve Civil nr 03/L-149 neni 11, neni 18 paragrafi 1,  
Rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010, Komuna Hani i Elezit Shpall këtë:

## KONKURS

**Titulli i vendit të punës:** Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa  
**Kategoria dhe grada :** (koeficienti 7)<sup>1</sup>  
**Kohëzgjatja e kontratës:** periudha provuese një vjeqare  
**Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:**

- Bën pregaditjen dhe hartimin e projekt buxhetit në nivel të organizatës buxhetore
- Bën pregaditjet dhe i prezenton drejtorit planet buxhetore, planet e rrjedhës së paras si dhe raportet financiare për periudh të caktuar dhe vjetore.
- Identifikon objektivat e buxhetit konform dispozitave ligjore dhe rekomandimeve nga niveli qendror
- Koordinon aktivitetet dhe bashkëpunimin me të gjitha programet buxhetore
- Bashkëpunon ngushtë dhe raporton me departamentet përkatëse të Ministrisë së Financave
- Bën pregaditjen e pasqyrave financiare
- Kryen edhe punë të tjera të caktuara nga drejtori.

<sup>1</sup> Kategoria dhe grada për këtë pozitë do të përcaktohet me nxjerrjen e aktit nënligjor nga Ministria e Administratës Publike

**Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim:** Kandidatët për këtë vend pune duhet ti plotësojnë këto kushte:

- Të kenë të kryer Fakultetin Ekonomik
- Të njohë punën në Kompjuter ( Word, Excel, Acces, etj.)
- Aftësi për të krijuar raporte të mira pune dhe ndërpersonale
- Aftësi të theksuara komunikimi në të shkruar dhe në të folur
- Referencë, mirënjohje apo çertifikatë të ndonjë institucioni apo organizate
- Të posedoj patent shofer

**Kërkesat specifike:**

- Dëshmi mbi kryerjen e obligimeve komunale

**Procedura e konkurimit:** Procedura e konkurimit është e hapur për gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

**Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:** Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin e Shërbyesve civil dhe rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010 e cila e rregullon rekrutimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.** Formularët e aplikimit mund të merren në zyrën e pritjes, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00 dhe do të dorëzohen po ashtu në zyrën e pritjes në objektin e Komunës kati i parë.

**Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente:** Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, kopjen e patent shoferit, certifikatën e lindjes si dhe çertifikata tjera mbi trajnimet e kryera.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor.

Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

*“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”*

*“Komunitetet jo-shumicë dhe pjestarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”*

Kryetari i Komunës  
Për Rufki Sumar

